

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Numri i Prokurimit	204-25-8572-5-1-1
---------------------------	--------------------------

Sa i përket tenderit për: “Ndërtimin e Inkubatorit të Biznesit në Pejë”

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Emri i Kompanisë: “Olti Trasing” SH.P.K

Adresa : Rr.Bill Clinton pn. 10 000 Prishtinë

Numri Telefonit: 045-500-535

Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj: Arjant Topanica

Adresa elektronike: prokurimi.oltitrasing@gmail.com

Data e parashtrimit të ankesës: 17.08.2026

Nënshkrimi dhe vula:



**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtoj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

1. B05- Njoftimi për kontrate: 06.10.2025
2. Pyetje nga OE dhe Përgjigje nga AK: 17.10.2026
3. B54- Formulari Standard për Korrigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara: 20.10.2025
4. Afati për dorëzim të tenderit: 14.11.2025
5. Kërkese për Rishqyrtim OE Elektrostublla SH.P.K: 14.11.2025
6. Vendim mbi refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim si e pa lejuar: 14.11.2025
7. Procesverbal i Hapjes së Tenderëve: 14.11.2025
8. Kërkese për vazhdimin e validitetit të ofertave dhe sigurimit të tenderit: 09.02.2026
9. Kërkese për vazhdimin e validitetit të ofertave dhe sigurimit të tenderit: 08.06.2026
10. B58- Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues: 24.07.2026
11. Kërkese për Rishqyrtim Olti Trasing SH.P.K: 29.07.2026
12. Vendim mbi pezullimin e aktivitetit të prokurimit: 30.07.2026
13. Vendimi i AK - Refuzim i Kërkesës për Rishqyrtim : 06.08.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po					Jo	X	
----	--	--	--	--	----	---	--

Hapja e ofertave është bërë në mënyrë elektronike me datën 14.11.2025 në ora 14:00

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	☒				Jo	☐	
----	-------------------------------------	--	--	--	----	--------------------------	--

Autoriteti Kontraktues – **Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë**, me datën **24.07.2026** në platformën e E-Prokurimit ka bere publikimin e Formularit B58- Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues **për anulim të aktivitetit të prokurimit** dhe Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar.

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po	☒	Jo	☐
----	-------------------------------------	----	--------------------------

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Me datën **29.07.2026** përmes platformës së e-prokurimit kemi dërguar Kërkesën për Rishqyrtim të Autoriteti Kontraktues – **Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë**. Me datën **06.08.2026** përmes platformës së E-prokurimit kemi pranuar përgjigjeje – Vendimin për refuzim të kërkesën ton për rishqyrtim si të pa bazuar nga Autoriteti Kontraktues- **Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë**.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92, (LPP), janë:

- Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;
- Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve;
- Neni 62- Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit
- Neni 72- Sqarimi i Tenderëve
- Neni 108/A - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Shkeljet e dispozitave - RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (RRPP 002/2024), janë:

Neni 38- Sqarimi i Tenderëve

Neni 40 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 43- Ndërprerja e procedurave të prokurimit

Neni 61- Pezullimi i aktivitetit të prokurimit

Shkeljet e dispozitave të UDHËZUESIT Nr. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK

10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

10.1 Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshtetësi rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues – **Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë** me datën **24.07.2026** në platformën e E-Prokurimit ka bere publikimin e Formularit B58- Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulim të aktivitetit të prokurimit.

Me datën **27.07.2026** përmes Platformës së E-prokurimit kemi bere kërkesë për qasje në dokumente e tenderit dhe Autoriteti Kontraktues me datën **28.07.2025**.

Bazuar në faktet dhe argumentet që posedojmë Kompania jone **nuk është pajtuar** me Vendimin e Autoritetit Kontraktues për Eliminimin e kompanisë tone nga aktiviteti i prokurimit dhe Vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulim të aktivitetit të prokurimit më datën **29.07.2026** përmes platformës së e-prokurimit kemi dërguar Kërkesën për Rishqyrtim të Autoriteti Kontraktues – **Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë**.

Me datën **06.08.2026** përmes platformës së E-prokurimit kemi pranuar përgjigjeje – Vendimin nga Autoriteti Kontraktues për refuzim të kërkesës ton për rishqyrtim si të pa bazuar.

Pretendimi ankimor nr.1 – Shkelje të nenit 6 të LPP dhe nenit 40 paragrafi 40.3 të RRPP 002/2024

Autoritetit Kontraktues – **Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë** me datën **14.11.2025** ka bere hapjen e ofertave dhe prej kësaj date deri me datën **24.07.2026** nuk ka përfunduar vlerësimin e ofertave. Gjate kësaj periudhe AK ka kërkuar dy herë nga OE që ta bëjnë vazhdimin e validitetit të ofertës dhe sigurimit të tenderit. Për shkak të neglizhencës dhe jo efikasitetit të AK gjate fazës së vlerësimit të ofertave, OE ju jane shkaktuar shpenzime shtese për faktin së çdo vazhdim i sigurimit të tenderit ka kosto shtesë që ju paguhen Bankave Afariste apo

Kompanive të Sigurimit , varësisht së ku i marrin Sigurimet e Tenderit. Vonesa prej **tete (8) muajve** e vlerësimit të ofertave është shkelje esenciale e legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik të aplikueshëm në Republikën e Kosovës, konkretisht **nenit 6 te LPP dhe nenit 40 paragrafi 40.3 e RRPP 002/2024. Kjo dëshmon edhe jo efikasitetin dhe efektivitetin e Zyrtareve të Autoritetit Kontraktues gjate fazës së vlerësimit të ofertave.**

Përshkrim i nenit 40 paragrafi 40.3 i RRPP 002/2024

40.3 Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve nga komisioni vlerësues, dhe nxjerrja e Njoftimit mbi vendimin e AK nga ZPP, do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe **jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh.** Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve.

Pretendimi 2 - Shkelje nenit 59 dhe 72 të LPP, nenit 38 dhe 40 të RRPP 002/2024 si dhe nenit 10 të Udhëzuesit Nr. 002/2024

Zyrtaret e AK - **Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë** gjate fazës së vlerësimit të ofertës të kompanisë tone Olti Trasing SH.P.K kane bere shkelje esenciale të legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik, konkretisht të nenit **59 dhe 72 të LPP, nenit 38 dhe 40 të Rregullores Nr.002/2024 për Prokurim Publik dhe nenit 10 të Udhëzuesit Nr. 002/2024 për Prokurim Publik`**

Arsyeja së pse ne konsiderojmë kështu janë:

(I)

Autoriteti Kontraktues- **Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë** gjate vlerësimit të ofertave, ofertën e kompanisë tone e ka konsideruar si oferte **të pa përgjegjshme** dhe me datën **24.07.2026** na ka dërguar **Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar.**

Autoriteti Kontraktues në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar të datës **24.07.2026** ka shënuar së Raporti i Pranimit Teknik për një objekt të ndërtuar ne cilësinë e veteinvestorit, mungon kontrata përkatëse dhe vlera financiare e projektit dhe së kjo dëshmi nuk e përmbushë kërkesat sipas njoftimit për kontrate dhe dosje të tenderit. Ky konstatim i AK **nuk qëndron për faktin së vete** AK ne Njoftimin për Kontrate dhe dosje të tenderit ka kërkuar si dëshmi, **Listën kontratave origjinal të vulosur dhe nënshkruar prej kompanisë si dhe kopja e referencave apo raporetet e pranimeve teknike për kontratat e njëjta.**

Kompania jone Olti Trasing SH.P.K për ta plotësuar këtë kërkesë së bashku me ofertën ka dorëzuar listën e kontratave origjinal dhe të nënshkruar si dhe listës ja kemi bashkangjitur Referencën për projektin **nr. 1** në liste si dhe Raportet e Pranimit Teknik për të gjitha projektet që i kemi shënuar në këtë liste prej **nr.2 deri ne nr. 11.** Vlera e realizuar e të gjitha projekteve që janë shënuar në liste dhe që janë dërguar dëshmitë është: **27,757,195.58 €.**

Në mesin e Raporteve të Pranimit Teknik është edhe Raporti i Pranimit Teknik të projektit – Ndërtimi i Kompleksit Afaristo Banesor “Donika II” 4B+P+19 (22) në Prishtinë të cilin e ka ndërtuar kompania jone Olti Trasing SH.P.K. dhe ka qene edhe investitor i këtij projekti.

Ky raport i Pranimit Teknik është hartuar dhe nënshkruar nga Komisioni i formuar nga Komuna e Prishtinës për pranimit teknik të objektit. Gjithashtu Komuna e Prishtinës – Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit e Komunës së Prishtinës bazuar ne Raportin Teknik me datën **29.05.2025** ka lëshuar **Certifikatën e Përdorimit: 05 NR.391/02-37349/25 DT.29.05.2025**

Në faqen nr. 13 të Raportit Teknik shënon së vlera investive e projektit në tërësi është 22,765,000.00 €.

Dëshmi: Certifikata e Përdorimit: 05 NR.391/02-37349/25 DT.29.05.2025

Raporti i Inspektimit për Pranim Teknik – Maj 2025

Me këtë Raport të Pranimit Teknik kompania jone Olti Trasing SH.P.K ka ofertuar për mbi 20 aktivitete të prokurimit të cilat janë publikuar nga Autoritetet Kontraktues të Republika së Kosovës dhe deri me tani asnjë nga këto Autoritete Kontraktues **nuk e kane konsideruar si të pa pranueshëm këtë dëshmi – raportin e Pranimit Teknik.**

Përshkrim i Kërkesës nga AK- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

1. Operatori Ekonomik duhet ofroj listën e kontratave per projekte të mëparshme të ngjashme të realizuara me sukses, që përfshinë projekte të ndërtimit të lartë, si objekte shoqërore, administrative apo banuese etj. Projektet e realizuara të natyrës së ngjashme duhet të jenë në tri vitet prej datës se njoftimit për kontratë që në total të kenë vlerë minimumi 5,113,233.75 €.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia- 1 Lista kontratave duhet te jete origjinal e vulosur dhe nënshkruar prej kompanisë si dhe kopja e referencave apo **raporetet e pranimeve teknike për kontratat e njëjta.**

Kompania jone së bashku me Kërkesën për Rishqyrtim prape ka dërguar të AK, Raportin e Pranimit Teknik të projektit – Ndërtimi i Kompleksit Afaristo Banesor “Donika II” 4B+P+19 (22) në Prishtinë, ku kemi nënvizuar vlerën prej **22,765,000.00 €** të projektit në **faqen 13** por Zyrtaret e AK edhe gjate fazës së shqyrtimit të Kërkesës tone për Rishqyrtim nuk e morën për baze këtë dëshmi dhe vazhduan me shkelje esenciale të legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik.

(II)

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar që na ka dërguar datën **24.07.2026** ka shënuar:

Për Inxhinierin e Diplomuar të makinerisë nuk keni ofruar licencën sipas njoftimit dhe dosje së tenderit.

Për ta plotësuar kërkesën për inxhinier të makinerisë Kompania jone së bashku me ofertën ka dorëzuar dëshmitë: Marrëveshjen paraprake me inxhinierin (XH.H), diplomën e universitare të fakultetit të makinerisë, CV dhe letër referencat.

Inxhinieri i makinerisë (XH.H) me të cilin kemi ofertuar posedon **LICENCEN A** me numër të licencës: **M-0062** të lëshuar nga **Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me datën 14.11.2024** dhe është valide deri me datën **14.11.2029**.

Dëshmi Licenca me nr. M-0062 me emër te XH.H e datës 14.11.2024.

Bazuar në **nenin 59 paragrafi 2, nenit 72 të LPP, nenit 38 paragrafi 38.3 të RRPP 002/2024 dhe nenit 10 paragrafi 10.1 të Udhëzuesit nr.002/2024**, Autoriteti Kontraktues është **dashur që të kërkoj sqarime dhe plotësim të dokumenteve**, në rastit konkret për licencën e inxhinierit të makinerisë (XH.H) për faktin së Licenca është dokument që ekzistenca e saj lehtësisht është e verifikueshme së ka qene para datës së ofertimit për faktin së është dokument që është lëshuar nga një Institucion shtetëror, **e jo të na eliminoj direkt nga aktiviteti i prokurimit pa kërkuar asnjë sqarim.**

Së bashku me Kërkesën për Rishqyrtim kemi dërguar të AK, **LICENCEN A** të Inxhinierit të Makinerisë, (XH.H) me numër të licencës: **M-0062** të lëshuar nga **Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me datën 14.11.2024** që është valide deri me datën **14.11.2029**. Por Zyrtaret e AK edhe gjate fazës së shqyrtimit të Kërkesës tone për Rishqyrtim edhe këtë **Licence – dëshmi nuk e morën për baze** dhe prape vazhduan me shkelje esenciale të legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik

Bazuar në këto fakte dhe argumente AK në asnjë mënyre nuk ka pasur të drejte për të na eliminuar direkt nga aktiviteti i prokurimit për faktin së bazuar në dispozitat e legjislacionit të prokurimit publik të shënuara me larte është dashur që të kërkoj informata - sqarime shtese.

(III)

Autoriteti Kontraktues- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar që na ka dërguar datën **24.07.2026** ka shënuar- **citojme:**

“Tek inxhinieri i ndërtimtarisë – konstruktiv – nga projektet e paraqitura ne reference nuk dëshmohet se inxhinieri posedon se paku 5 vite përvojë profesionale ne fushën e ndërtimit te larte, pasi projektet qe i përkasin kësaj fushe janë të kufizuara në periudhën 2014-2016, ndërsa projektet e viteve të tjera lidhen kryesisht me ndërtimin e ulet (rruge, ura autostrada dhe infrastrukturë) ”, **mbarim i citatit.**

Edhe ky konstatim i AK nuk qëndron , për faktin së Inxhinieri i ndërtimtarisë – konstruktiv (R.Z) jo vetëm që e plotëson eksperiencën 5 vjeçare në ndërtimet e larta të kërkuara nga AK. por edhe e tejkalon.

Vetëm për projektin ku ka qene i angazhuar inxhinieri i ndërtimtarisë konstruktiv (RZ) - **Ndërtimi i kompleksit Afarist- Banesor “ Famis CO HC “ SH.A- Prishtine , vlera e kontratës**

8,230,757.50 €, data e fillimit të punimeve është 29.11.2011 dhe data e pranimit teknik është 01.04.2017. Vetëm për mbikëqyrjen e punëve të këtij objekti – për të cilën posedon edhe Reference të lëshuar nga kompania Famis CO HC “ SH.A, inxhinieri i ndërtimtarisë – konstruktiv (R.S) me të cilin kemi ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit e **tejkalon eksperiencën 5 vjeçare të kërkuar nga AK.**

Inxhinier i ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv (R.Z) në kompaninë Famis CO HC “ SH.A ka menaxhuar projekte nga Maj i vitit 2008 deri ne Korrik të vitit 2022. Kjo periudhe e angazhimit e përfshinë edhe projektin: Ndërtimi i kompleksit Afarist- Banesor “ Famis CO HC “ SH.A- Prishtine.

Nese Komisioni i Vlerësimit të ofertave ka pasur paqartësi lidhur me dëshmitë për eksperiencën e inxhinierit të Ndërtimtarisë – Konstruktiv (R.Z) është dashur që të veproj konforme dispozitave të legjislacionit të prokurimit publik të shenura me lartë e jo automatikisht të na eliminoj nga aktiviteti i prokurimit.

Së bashku me Kërkesën për Rishqyrtim kemi dërguar të AK edhe Raportin e Pranimit Teknik të Ndërtimi i kompleksit Afarist- Banesor “ Famis CO HC “ SH.A- Prishtine të cilin e ka menaxhuar Inxhinieri i Ndërtimtarisë – Konstruktiv (R.Z) për të cilin posedon edhe reference të cilën e kemi dërguar të AK së bashku me ofertën të lëshuar nga kompania - Famis CO HC “ SH.A ku në mesin e shume projekteve është e shënuar edhe Projekti - Ndërtimi i kompleksit Afarist- Banesor “ Famis CO HC “ SH.A- Prishtine.

Dëshmi – Procesverbalit të Pranimit teknik kompleksit Afarist- Banesor “ Famis CO HC “ SH.A. Referenca e lëshuar nga Famis CO HC “ SH.A- për Inxhinierin e Ndërtimtarisë – Konstruktiv (R.Z)

Inxhinieri i Ndërtimtarisë – Konstruktiv (R.Z) është i angazhuar në kompaninë tone Olti Trasing SH.P.K në mbikëqyrjen e projekteve që jemi duke realizuar që nga Nëntori i vitit 2022 dhe ende vazhdon.

Projekte të cilat jemi duke i realizuar e qe menaxher i kontratës është inxhinieri i Ndërtimtarisë – Konstruktiv (RZ) janë ;

1. Nderimi i Sallës të Edukatës Fizike për SHFMU: “Gjergj Fishta” të financuar nga Komuna e Prishtinës – Kontrata është nënshkruar me datën 03.08.2023
2. Ndërtimi Qerdhës ne Bardhosh të financuar nga Ministria e Arsimit - Kontrata është nënshkruar me datën 30.05.2025

Dëshmi – Kontratat me Autoritetet Kontraktuese dhe Vendimi i Emërimit të Menaxherit (R.Z).

Përshkrim i nenit 59 paragrafi 2 i LPP

2.Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkojen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.

Përshkrim i nenit 72 të LPP

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.
2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë **certifikatat** dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.
3. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Përshkrim i nenit 38.3 të RRPP 002/2024

38.3 Megjithatë, lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkojë dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyrë objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve.

Përshkrim i nenit 10 paragrafi 10.1 i Udhëzuesit 002/2024

10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

10.1 Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veprojë në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së

Mungon licenca - Mund të kërkojnë informata sqaruese

Bazuar në të gjitha të dhënat e shënuara më lartë shihet se Autoriteti Kontraktues - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, vlerësimin e ofertës tone dhe vendimin për refuzim si të pa bazuar të Kërkesës tone për Rishqyrtim e ka marrë në kundërshtim të plote me legjislacionin primar dhe sekondar të prokurimit publik të aplikueshëm në Republikën e Kosovës, konkretisht në kundërshtim me nenin 59 dhe 72 të LPP, nenit 38 dhe 40 të RRPP 002/2024 si dhe nenit 10 paragrafi 10.1 të Udhëzuesit Nr. 002/2024

Pretendimi ankimor nr. 3 - Shkelje nenit 62 të LPP dhe nenit 43 të RRPP 002/2024

Nisur nga fakti që oferta e kompanisë tone Olti Trasing SH.P.K është ofertë e përgjegjshme dhe me çmimin total me vetëm **2,877,000.00 €**, që është për **531,822.50 €** më e lirë se vlera e parashikuar nga vete Autoriteti Kontraktues (**3,408,822.50 - 2,877,000.00 = 531,822.50**), konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues nuk ka pasur asnjë arsyeje të vetme ligjore për të marrë **vendim për anulim të aktivitetit të prokurimit**.

Prandaj ne konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, vendimin për anulim të aktivitetit të prokurimit e ka marrë në kundërshtim të plote me legjislacionin e prokurimit publik, konkretisht në kundërshtim me nenin **62 të LPP dhe nenin 43 të RRPP 002/2024**.

Përshkrim i nenit 62 të LPP

1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njëërën nga arsyet:
 - 1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodhë në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.
2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njëërën nga arsyet:
 - 2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit;

Pretendimi ankimor nr. 4 - Shkelje nenit 108/A paragrafi 6 të LPP, nenit 61 paragrafi 61.3 të RRPP 002/2024.

Kompania jone Oltoi Trasing SH.P.K me datën **29.07.2026** për mes platformës së e-prokurimit ka dërguar Kërkesën për Rishqyrtim të Autoriteti Kontraktues - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Autoriteti Kontraktues me datën **30.07.2026** në platformën e e-prokurimit ka publikuar Vendimin për Pezullim të aktivitetit të prokurimit.

Zyrtaret Përgjegjës të Autoritetit Kontraktues deri me datën **06.08.2026** nuk kanë shqyrtuar Kërkesën tone për Rishqyrtim dhe nuk kanë publikuar asnjë Vendim në platformën e e-Prokurimit për të na informuar për shtyrje të afatit për shqyrtimin e Kërkesës tone për Rishqyrtim ashtu siq e kërkon neni 108/A, paragrafi 6 i LPP dhe neni 61 paragrafi 61.3 i RRPP Nr.002/2024

Ky veprim i Zyrtareve Përgjegjës të AK është në kundërshtim të plote me nenin 108/A paragrafi 6 të LPP dhe nenit 61 paragrafi 61.3 të RRPP Nr. 002/2024.

Përshkrim i nenit 108/A paragrafi 6 të LPP

6. Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën **brenda tre (3) ditë pune** nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informative shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni. Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për **jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë.**

Përshkrim i nenit 61 paragrafi 61.3 të RRPP Nr.002/2024

61.3 Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, do të publikojë Kërkesën për rishqyrtim në Platformë tek dosja e tenderit në “shtet dokument shtesë” dhe do ta shqyrtojë kërkesën **brenda tre (3) ditë pune** nga data e parashtrimit të kërkesës, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informatave shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në nenin 60.2 të kësaj rregullore. Ky afat, në raste

specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë.

Pretendimet Ankimore lidhur me ofertat e Operatoreve Ekonomik:

- 1. Grupi i OE: NSHT. Viktori Com : Marisa SH.P.K**
- 2. Pro & CO Group SH.P.K**
- 3. Hidro Projekt SH.P.K ; Triangle SH.P.K**

Pas analizimit të dokumenteve që kemi pranuar nga Autoriteti Kontraktues kur kemi qene në qasje të dokumenteve të tenderit me datën **28.07.2026**, kemi konstatuar së eliminimi nga aktiviteti i prokurimit të këtyre tre Operatoreve Ekonomik nga Autoriteti Kontraktues është bere në harmoni me legjislacionin e prokurimit publik për faktin së as njeri prej tyre nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues të kërkuara në Njoftimin për Kontrate dhe Dosje të Tenderit.

Bazuar në të gjitha këto që i cekem me larte dhe bazuar në dispozitat e legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik të cekura me larte, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP –së, që Ankesën tone ta konsideroje si të bazuar dhe lenden ta ktheje në Ri-vlerësim.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Kompania jone është dëmtuar për shpenzimet e bëra me rastin e përgatitjes së Ofertës shume voluminozë, Shpezimet e vazhdimit te sigurimit të tenderit (dy here), shpenzimet përgatitjes së Kërkesës për Ri shqyrtim, shpenzimet e përgatitjes së Ankesës për OSHP dhe fitimet e pritura.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

1. B05- Njoftimi për kontrate: 06.10.2025
2. Pyetje nga OE dhe Përgjigje nga AK: 17.10.2026
3. B54- Formulari Standard për Korrigjimin
4. Kërkese për Rishqyrtim OE Elektrostublla SH.P.K: 14.11.2025
5. Vendim mbi refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim si e pa lejuar: 14.11.2025
6. Procesverbal i Hapjes së Tendereve:14.11.2025
7. Kërkese për vazhdimin e validitetit të ofertave dhe sigurimit të tenderit: 09.02.2026
8. Kërkese për vazhdimin e validitetit të ofertave dhe sigurimit të tenderit: 08.06.2026
9. B58- Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues:24.07.2026
10. Kërkese për Rishqyrtim Olti Trasing SH.P.K: 29.07.2026
11. Vendim mbi pezullimin e aktivitetit të prokurimit:30.07.2026
12. Vendimi i AK - Refuzim i Kërkesës për Rishqyrtim : 06.08.2026
13. Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 te LPP-së;

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*